



Federata e Para Boccia të Kosovës

STATUTI

I

FEDERATA PARA BOCCIA TË KOSOVËS

Prishtinë, 2025

Në bazë të nenit 19 të Ligjit Nr. 08/L-277 për Sport dhe në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-244, Ligjin për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Tjera Negative në Ngjarjet Sportive. Kuvendi i Federatës së Para Boccia të Kosovës, me datë 03.05.2025 miraton këtë:

STATUT TË FEDERATËS SË PARA BOCCIA TË KOSOVËS

DIPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i Statutit

Me këtë Statut rregullohet organizimi, funksionimi dhe aktivitetet e Federatës së Para Boccia të Kosovës (në tekstin e metejmë FPBOK), organet, përgjegjësia dhe kompetenca e tyre si dhe përbërja e tyre.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Statuti zbatohen ndaj të gjithë anëtarëve të regjistruar në FPBOK.

Neni 3

Parimet

1. Të gjitha veprimet e Federatës dhe anëtarëve të saj bazohen në parimet e përgjithshme si në vijim:
 - 1.1. Boccia për të gjithë – çdo person ka të drejtë të merret me sportin e boccia, përfshirë aktivitetin fizik të ndërlidhur. FPBOK dhe anëtarët e saj promovojnë përfshirjen në sport, gjegjësisht në para boccia.
 - 1.2. Ligjshmëria - veprimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit ose legjislacionit tjetër përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës. Çdo kufizim ose ndalim i një të drejte në fushën e sportit duhet të bazohet në ligj ose aktet normative të FPBOK-së;
 - 1.3. Qeverisja e mirë - respektimi dhe zbatimi i Kodit të Qeverisjes së Mirë të përcaktuar me ligjin në Kosovë, respektimi i rregullave përkatëse etike dhe rregullave të tjera ndërkombëtare për qeverisjen e mirë;
 - 1.4. **Mosdiskriminimi** – garantimi i pjesëmarrjes në sportin e boccia dhe në qasje në infrastrukturë sportive në përputhje me ligj dhe rregullat e tjera përkatëse, si dhe ndalimi i diskriminimit në çfarëdo baze të përcaktuar me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi;
 - 1.5. **Ambienti i sigurt dhe i favorshëm për të gjithë** – ambientet në të cilat zhvillohen veprimtaritë sportive duhet të jenë të sigurta, ku të gjithë personat e përfshirë në sportin e boccia trajtohen me respekt, dinjitet dhe pa ngacmim si dhe në përputhje me

standardet që mbrojnë shëndetin e tyre. Çdo dhunë, keqpërdorim, abuzim ose dukuri tjetër negative ndalohet dhe sanksionohet me ligj;

- 1.6. **Transparenca** – veprimet duhet të jenë transparente dhe dokumentet publike duhet të jenë të qasshme në përputhje me ligjin përkatës për qasjen në dokumente publike;
- 1.7. **Mbrojtja e privatësisë** – veprimet nuk cenojnë privatësinë dhe të dhënat personale të personave të përfshirë në aktivitet sportiv mbrohen në përputhje me ligjin përkatës;
- 1.8. **Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve** – ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës në sportin e boccia, në të cilat përfshihen njoftimi i policisë, organit të kujdestarisë dhe organeve të tjera shtetërore përkatëse për çdo lloj dhune ndaj tyre, keqpërdorim, ngacmim ose sjellje tjetër të pahijshme;
- 1.9. **Mbrojtja e mjedisit dhe siguria publike** – ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për mjedisin dhe natyrën gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive, në përputhje me legjislacionin përkatës, si dhe mos-cenimi i sigurisë publike;
- 1.10. **Fair-play** – sporti i boccia zhvillohet në bazë të rregullave, konkurrencës së ndershme, respektit ndaj kundërshtarit, parandalimit dhe shmangjes së dhunës dhe sjelljes jo të drejtë.

Neni 4

Emri dhe selia e organizatës

1. Emri i organizatës është: Federata e Para Boccia të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm do të referohet si: FPBOK).
2. Emri i shkurtë i Federatës është FPBOK.
3. Selia e FPBOK është në Prishtinë, Emshir, Rruga Ymer Aliu, EXCD Llamella C4, nr.35

Neni 5

Statusi i FPBOK

1. FPBOK është person juridik i pavarur jofitimprurës, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës në fuqi, misioni i së cilës është të zhvillojë forma të ndryshme të boccia në Kosovë në të gjitha nivelet për personat me aftësi të kufizuara siç përcaktohet nga Rregulloret e Klasifikimit.
2. FPBOK gjatë veprimtarisë së saj është e obliguar të respektoj legjislacionin e Republikës së Kosovës në fushën e sportit dhe fushat tjera që ndërlidhen me organizimet sportive.
3. FPBOK është autoriteti i vetëm që organizon dhe qeverisë sportin e boccia në Republikën e Kosovës.

Neni 6

Përmbajtja e logos, flamurit dhe vulave

1. Logoja e FPBOK-së përbëhet nga figura e kaltërt dhe 3 topa të boccia me ngjyrat, kuq, kaltërt dhe bardh dhe me lakoren ngjyrë verdh vizëllësues, ku kuptimi i saj është që lojtarët e boccia në Kosovë do të shkelqejnë në aren sportive ndërkombëtare.
2. Logoja e FPBOK-së është e mbrojtur dhe duhet të përdoret vetëm në komunikimet zyrtare të FPBOK-së. Përdorimi i logos së FPBOK-së nga subjektet tjera mund të bëhet vetëm me leje paraprake nga Sekretari i përgjithshëm i FPBOK-së.

3. Logon dhe flamurin e FPBOK-së e miraton Kuvendi i FPBOK-së me 50% + 1 e delegatëve të pranishëm në mbledhje.
4. FPBOK-ja ka vulën drejtkëndore dhe vulën e rrumbullakët, të cilat përdoren në pajtim me Ligjin mbi vulat zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren e Brendshme të FPBOK-së.

Neni 7

Regjistrimi dhe Anëtarësimi në FPBOK

1. Anëtarë të Federatës janë klubet e para boccias të cilat licencohen në Federatë.
2. Anëtarësia e klubeve në Federatë sigurohet pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të anëtarësimit nga ana e subjektit që aplikon për regjistrim, të cilat janë të përcaktuara në vijim:
 - 2.1. Regjistrimi i subjektit si organizatë joqeveritare apo shoqëri tregtare, në përputhje me ligjet përkatëse;
 - 2.2. Statuti dhe aktet tjera normative për themelimin e klubit sportiv të miratuara;
 - 2.3. Strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës;
 - 2.4. Vendimi i komunës me të cilin dëshmohet selia e klubit ku ushtron veprimtarinë sportive bazë të tij;
 - 2.5. Posedimi i infrastrukturës optimale për ushtrimin e veprimtarisë sportive të klubit, që vërtetohet nga Komisioni i garave;
 - 2.6. Lista e sportistëve që janë pjesë e klubit dhe trajnerin e angazhuar që plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për Sport;
 - 2.7. Dokumentet përcjellëse të nevojshme sipas rregulloreve përkatëse të FPBOK-së.
3. Anëtarësia për pranimin përfundimtar të anëtarëve të rinj në FPBOK e bënë Kuvendi i FPBOK-së në mbledhjen e radhës, në të cilën anëtari i sapo pranuar nuk ka të drejtë vote.
4. Anëtarëve të rinj në FPBOK, e drejta e votës ju njihet menjëher pas pranimit në Federatë.

Neni 8

Pezullimi dhe shuarja e statusit të anëtarëve

1. Të gjithë anëtarët e Federatës obligohen të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësisë, të cilën e cakton Bordi i Federatës.
2. Statusi i anëtarit përfundon në rast të dorëheqjes, përjashtimit, apo shkrirjes së anëtarit. Në rast të përfundimit të statusit të anëtarit, anëtari detyrohet të kthejë të gjitha asetet që i përkasin Federatës. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, burimet financiare, pajisjet sportive ose çdo pronë tjetër që mund të jetë dhënë nga Federata gjatë periudhës së anëtarësimit.
3. Anëtari i FPBOK-së mund të heqë dorë nga anëtarësia, duke bërë kërkesën me shkrim. Kërkesa përcillet në Kuvendin e radhës pasi që anëtari në dorëheqje t'i përmbushë të gjitha obligimet financiare ndaj FPBOK-së.

4. Anëtari i Federatës mund të përjashtohet nga Federata në rast të shkeljes së Statutit apo akteve tjera normative të Federatës. Vendimin preliminar për pezullimin e anëtarësisë së anëtarëve e merr Komisioni Disiplinor, ndërsa vendimin për përjashtimin e miraton Kuvendi i Federatës me vendim të 50%+1 të delegatëve të pranishëm në Kuvend.

5. Anëtarësia në Federatë konsiderohet e pezulluar për të gjitha klubet të cilat nuk marrin pjesë në garat e organizuara për stinorin aktual, apo të cilat nuk kanë marrë pjesë në gara përgjatë tërë stinorit paraprak në rastet kur mbledhja e Kuvendit mbahet gjatë pauzës në mes stinorëve. Në rast të tillë, delegatët e klubeve në Kuvendin e Federatës mund të jenë pjesëmarrës në cilësinë e vëzhguesit dhe pa të drejtë vote. Anëtarësia konsideruar e ndërprerë për të gjitha klubet që nuk marrin pjesë në dy stinor të njëpasnjëshëm garues.

Neni 9

Anëtarësimi dhe përfaqësimi i FPBOK-së

1. FPBOK është anëtar i Komitetit Paralimpik të Kosovës (KPK), Federatës Ndërkombëtare të Boccia (BISFED).
2. FPBOK me vendim të Bordit, mund të anëtarësohet edhe në asociacione tjera sportive vendore dhe ndërkombëtare që kanë të njëjtën veprimtari.
3. FPBOK dhe anëtarët e saj gjatë veprimtarisë së tyre nuk mund te promovojne asnjë aktivitet politik apo fetar.
4. FPBOK përfaqësohet nga Kryetari i cili është edhe përfaqësues i autorizuar i organizatës.
5. Modalitetet dhe nivelet e përfaqësimit të FPBOK-së përcaktohen me Rregulloren e Brendshme të FPBOK-së.
6. FPBOK per aktivitetet, informon anëtarët e saj, mediat dhe opinionin.

Neni 10

Qëllimet e FPBOK-së

1. Qëllimet themelore të FPBOK-së janë:
 - 1.1. Masovizimi, afirmimi dhe zhvillimi i sportit të boccia në të gjithë territorin në Republikën e Kosovës.
 - 1.2. Lidhjen e anëtarëve me njëri-tjetrin për të inkurajuar personat me dhe pa aftësi të kufizuara që të mirren me sport, veçanërisht me boccia.
 - 1.3. Avancimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve, klasifikatorëve, vëzhguesve dhe anëtarëve tjerë në sportin e boccia.
 - 1.4. Sigurimi i ndihmës për organizatat dhe subjektet tjera që kanë për qëllim promovimin e sportit të boccia.
 - 1.5. Organizimi dhe promovimi i boccia sipas rregullave të organizatës ndërkombëtare BISFED dhe sipas rregullave të Federatës për të gjitha kategoritë dhe gjinitë, si dhe përcaktimi i sistemeve të garave për të njëjtat.
 - 1.6. Avancimi i sportit të boccia përmes pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - 1.7. Organizimi i kampeve, seminareve, punëtorive,debateve dhe tubimeve të tjera si dhe publikimeve profesionale.

1.8. Sigurimi i bazës materiale për funksionimin, zhvillimin dhe avancimin e veprimtarisë së FPBOK-së.

1.9. Mbështetja e anëtarëve të FPBOK-së me mjete financiare siç përcaktohet në rregulloren për organizim të brendshëm.

1.10. Parandalimi dhe ndalimi i përdorimit të dopingut dhe substancave të ndaluara duke u bazuar në rregullat e WADA-s.

1.11. Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Tjera Negative në Ngjarjet Sportive.

1.12. Respektimi i Kodit të mirësjelljes (etik).

Neni 11 **Pasuria e FPBOK-së**

1. Pasuria e FPBOK do të përbëhet nga pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme, e cila krijohet nga:
 - 1.1. Subvencionet e Ministrisë përkatëse për Sport
 - 1.2. Kuotizimet;
 - 1.3. Donacionet;
 - 1.4. Burimet tjera të ligjshme.
2. FPBOK, në mënyrën e paraparë me dispozitat ligjore, aktet nënligjore dhe aktet e FPBOK-së në pajtim me vendimin paraprak të organit kompetent të FPBOK disponon me pasuritë dhe mjetet e veta.
3. Sekretari i përgjithshëm në kordinim me Kryetarin e FPBOK-së në baza vjetore përgatitin raportin financiar dhe planin buxhetor për vitin financiar të radhës ku së bashku me arsyetimet përkatëse duhet t'i dorëzohen Bordit për aprovim para se ti dorëzohet për miratim Kuvendit të FPBOK-së.
4. Bordi i FPBOK harton dhe propozon rregulloren financiare, ndërsa miratohet nga Kuvendi, me të cilin përcaktohen procedurat e menaxhimit të buxhetit dhe të pasurisë së FPBOK-së.

Neni 12 **Lartësia e kuotizimit për anëtarësim në FPBOK**

Lartësinë dhe afatin e kuotizimit të anëtarëve, e përcakton Bordi i FPBOK-së me vendim, e cila duhet të paguhet në llogarinë bankare të FPBOK-së.

Neni 13 **Organet e FPBOK-së**

1. FPBOK e zhvillon veprimtarinë e saj përmes organeve të cilat i përcakton ky Statut, e të cilat janë:
 - 1.1. Kuvendi i FPBOK-së, te cilin e përbëjnë delegatët e anëtarëve;
 - 1.2. Kryetari i FPBOK-së;
 - 1.3. Bordi i FPBOK-së;
 - 1.4. Këshilli Mbikëqyrës i FPBOK-së;

1.5. Komisioni i Etikës

2. Mandati i Organeve të FPBOK-së është katër (4) vjet me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat të njëpasnjëshëm.

2.1. Mandati i anëtarëve të Organeve të FPBOK-së përfundon:

2.1.1. kur përfundon mandati prej katër (4) viteve

2.1.2. me dorëheqje;

2.1.3. me shkarkim

2.1.4. apo raste të tjera të parapara me ligj dhe statut.

Neni 14

Paanshmëria dhe shmangia e konfliktit të interes

1. Cdo anëtar në organet FPBOK-së e njofton organin përkatës se ka konflikt interesi për të kryer ndonjë aktivitet për FPBOK-n, në qoftë se:

1.1. është vetë palë, përfaqësues, apo në qoftë se me palën ka ndonjë interes financiar;

1.2. me palën ose me përfaqësuesin e saj është në lidhje gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt;

1.3. në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar se ekzistuar.

1.4. është aksionar apo anëtar i personit juridik që është palë në procedurë; si dhe

1.5. ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanshmërinë e tij.

2. Në rast të ekzistimit të rrethanave të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni, anëtarë në organet FPBOK e njofton mbikëqyrësin e drejtpërdrejt. Mos lajmërimi i konfliktit të interesit nga ana e anëtarit të organit të FPBOK-së përbën bazë për iniciimin e procedurës disiplinore.

3. Vendimi i marrë nga një anëtar i organeve të FPBOK-së e i cili vërtetohet se ka qenë në konflikt interesi, vendimi shpallet dhe i njëjti nuk prodhon efekt juridik për qelimin që është nxjerrë.

Neni 15

Kuvendi i FPBOK-së

1. Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës i FPBOK-së.

2. Kuvendin e përbëjnë delegatët e autorizuar të anëtarëve të FPBOK-së.

3. Numri i delegatëve të ftuar në Kuvend të FPBOK-së është si në vijim:

3.1. Kryetari i FPBOK-së është delegat i kuvendit me automatizëm.

3.2. Secili klub, anëtarë i FPBOK-së përfaqësohet në kuvend me 3 delegatë.

4. Kuvendi punimet e veta i zhvillon në mbledhje, në të cilat ftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit, të cilët kanë të drejtë vote.

4.1. Në Kuvend ftohen edhe anëtarët tjerë të FPBOK-së në cilësinë e vëzhguesit në pajtim me nenin 7 të këtij Statuti.

5. Në mbledhje të Kuvendit ftohen të marrin pjesë edhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të FPBOK-së, por pa të drejtë vote.

6. Mbledhjet e Kuvendit janë të hapura për mediat, dhe në to mund të ftohen edhe mysafirë të tjerë, të cilët nuk kanë të drejtë fjale dhe vote. Përrjashtim nga kjo bënë rasti kur kryesuesi i jep të drejtën e fjalës dhe qëndrimin në ambientet ku mbahet kuvendi.

Neni 16

Delegatët e Kuvendit

1. Çdo delegat në Kuvend, i autorizuar paraprakisht nga klubet ka të drejtën e një vote.
2. Delegatët në Kuvend mund të zgjidhen në njërën nga pozitat tjera në organet e FPBOK-së.
3. Anëtari i FPBOK-së mund të zëvendësojë delegatët e vetë edhe gjatë mandatit, duke e informuar FPBOK-në me shkrim mbi delegatin zëvendësues, së paku pesë (5) ditë para mbajtjes së Kuvendit.

Neni 17

Mandati i Delegatit

1. Mandati i delegatëve në Kuvend zgjatë katër (4) vite.
2. Delegati i përgjigjet anëtarit të FPBOK-së që e ka deleguar dhe Kuvendit ku ai ushtron detyrën e delegatit.

Neni 18

Mbledhja e Kuvendit

1. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta (të punës dhe zgjedhor) dhe të jashtëzakonshme.
2. Kuvendi i rregullt (punës) mbahet sipas nevojës, por së paku një (1) herë në vit siç parashihet me vendimin e Ministrisë përkatëse për Sport, dhe Kuvendi zgjedhor sipas ciklit paralimpik.
3. Kuvendin e rregullt (punës) e Thërret Kryetari ose shumica e anëtarëve të Bordit me vendim.
4. Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta inicioj Kryetari, shumica e anëtarëve të Bordit ose shumica e Anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit.
5. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të trajtoj dhe vendosë vetëm për çështjet për të cilat është thirrur.
6. Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta thërrasë Kryetari i FPBOK-së, dhe të mbahet jo më vonë se 15 ditë pune, pas inicimit të tij nga organet e FPBOK-së sipas paragrafit 4 të këtij neni.
7. Në rast të mos thirrjes së Kuvendit të Jashtëzakonshëm nga Kryetari i FPBOK-së sipas paragrafit 4 të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm i FPBOK-së brenda tri (3) ditëve obligohet të thërrasë Kuvendin e Jashtëzakonshëm.
8. Në rast të mos thirrjes së Kuvendit të Jashtëzakonshëm nga Sekretari i Përgjithshëm për çfarëdo rrethane, atë obligohet ta thërret organi iniciues brenda tri (3) ditëve.
9. Mos thirrja e Kuvendit të Jashtëzakonshëm nga Kryetari dhe Sekretari i përgjithshëm sipas dispozitave të këtij neni është shkelje e Statutit dhe të njëjtëve ju mohohet e drejta e fjalës dhe votës në këtë kuvend të jashtëzakonshëm.
10. Ftesa për mbledhje të Kuvendit të Rregullt (punës) duhet tu dërgohet të gjithë Anëtarëve më së largu 7 ditë pune para mbajtjes së Kuvendit, ndërsa materiali që do shtjellohet në mbledhje së paku 4 ditë pune para takimit.
11. Ftesa për Kuvend të Jashtëzakonshëm duhet tu dërgohet të gjithë anëtarëve të Kuvendit së paku 24 orë para mbajtjes së Kuvendit.

12. Federata e Para Boccia të Kosovës mund të organizojë mbledhjet e Kuvendit në formë fizike, online apo të kombinuara fizike dhe online, kur rrethanat e jashtëzakonshme apo nevojat e veçanta të organizimit e kërkojnë një gjë të tillë. Pjesëmarrësit në këto mbledhje do të konsiderohen të pranishëm dhe me të drejtë vote në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Rregullorja e Punës së Kuvendit, me kusht që të përdoren mjete teknologjike që sigurojnë identifikimin dhe pjesëmarrjen e plotë të anëtarëve dhe votim të sigurt dhe transparencë.

Neni 19

Vendimmarrja në Kuvend të përgjithshëm

1. Kuvendi zgjedhor e zgjedhë kryesinë e punës dhe organet tjera punuese me rastin e fillimit të mbledhjes së Kuvendit.
2. Kryesinë e punës në mbledhjet e Kuvendit zgjedhor do ta përbëjnë Sekretari i përgjithshëm i FPBOK-së dhe dy delegatë të Kuvendit.
3. Kryesia e punës udhëheqë me punimet e Kuvendit zgjedhor në bazë të rregullores së Punës të Kuvendit të FPBOK-së.
4. Kuvendin e rregullt dhe të jashtëzakonshëm e udhëheqë Kryetari së bashku me Nënkryetarin dhe Sekretarin e përgjithshëm.
5. Kuorumi i Kuvendit përbëhet nga 50% +1 e delegatëve të përgjithshëm
6. Vendimet konsiderohen të miratuara nëse pro (për) kanë votuar 50% + 1 e delegatëve të pranishëm në mbledhje.
7. Përjashtimisht kësaj dispozite, vendimi për pushimin e veprimtarisë së FPBOK-së bëhet me 2/3 e anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit, ndryshimi i Statutit të FPBOK-së ndërsa miratimi i logos dhe flamurit bëhet sipas Nenit 6, pika 3 të këtij Statuti.
8. Forma e votimit në kuvend është publike, kurse e fshehtë në rastin e zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarëve dhe anëtarët bordit të FPBOK, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe sipas rrethanave.
 - 8.1. Votimi në kuvend është pro, kundër ose abstenim (abstenimi numërohet me votat kundër).
9. Vendimet e Kuvendit janë të obligueshme për të gjithë Anëtarët dhe organet e FPBOK-së.

Neni 20

Kompetencat e Kuvendit të FPBOK-së

1. Kuvendi i FPBOK-së është organi më i lartë dhe ka këto kompetenca si në vijim:
 - 1.1. Miraton Statutin e FPBOK-së;
 - 1.2. Miraton Rregulloren për Organizim të Brëndshëm të FPBOK-së.
 - 1.3. Miraton Rregulloret për sistemin e garave për të gjitha kategoritë;
 - 1.4. Miraton Rregulloren e Punës së Kuvendit, Bordit, Këshillit Mbikqyrës dhe Komisionit të Ankesave të FPBOK;
 - 1.5. Miraton planet dhe raportet e punës së organeve të FPBOK-së;
 - 1.6. Miraton planin financiar dhe raportin financiar vjetor.
 - 1.7. Miraton pranimin e Anëtarëve të rinj dhe pushon anëtarësinë e Anëtarëve aktual të FPBOK-së.
 - 1.8. Zgjedhë dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Bordit.

- 1.9 Zgjedhë dhe shkarkon Këshillin Mbikëqyrës.
- 1.10 Zgjedhë dhe shkarkon Komisionin e Etikës
- 1.11. Vendos mbi faljen e dënimeve të formës së prerë nëse plotësohen kushtet e parapara në aktin përkatës.
- 1.12. Kryen punë tjera, në përputhje me Statutin dhe aktet tjera normative të Federatës.
- 1.13. Miraton logon, flamurin dhe vulat e FPBOK-së

Neni 21

BORDI I FPBOK-së

1. Bordi është organi më i lartë drejtues dhe ekzekutiv i FPBOK-së. Bordi për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të FPBOK-së.
2. Mënyra dhe procedurat e punës së Bordit të FPBOK-ës përcaktohen me Rregulloren e Punës së Bordit të FPBOK-së.

Neni 22

Përbërja dhe zgjedhja Anëtarëve të Bordit

1. Bordi numëron gjithsej 7 anëtarë dhe përbëhet nga: Kryetari, nënkryetari dhe pesë (5) anëtarë. Së paku një anëtar i Bordit duhet të jetë përfaqësues i sportistëve.
2. Kryetari, nënkryetari dhe pesë (5) anëtarë të Bordit i zgjedhë Kuvendi me shumicë votash. Së paku Dy (2) nga anëtarët e Bordit të zgjedhur nga Kuvendi duhet të jenë të gjinisë femërore.
3. Procedura e zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Bordit nga Kuvendi i Federatës përcaktohet në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Federatës.
4. Përfaqësimi gjinor në Bordin e Federatës duhet të jetë në pajtim me dispozitat ligjore mbi sportin në Kosovë.

Neni 23

Mandati i anëtarëve të Bordit

1. Anëtarët e Bordit zgjidhen me mandat katër (4) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje për mandate të njëpasnjëshëm.
2. Anëtarët e Bordit ose i tërë Bordi mund të shkarkohen nga Kuvendi edhe para skadimit të mandatit, në qoftë se vërtetohet se të njëjtit kanë punuar në kundërshtim me ligjin, këtë Statut dhe aktet e tjera normative të Federatës.
3. Në rast të pushimit mandatit të anëtarit të Bordit të zgjedhur nga Kuvendi, për çfarëdo arsye, Kuvendi në takimin e parë të radhës do ta zgjedhë anëtarin e ri për kohën e mbetur.
4. Anëtari i Bordit të zgjedhur nga Kuvendi që nuk merr pjesë së paku në tre (3) mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit pa arsye, i njëjti lirohet nga detyra me vendim të Bordit. Ky vendim i dërgohet Kuvendit të radhës për zëvendësim.
5. Në rast të dorëheqjes të shumicës së anëtarëve të Bordit, Kryetari është i obliguar të thërras Kuvendin e Jashtëzakonshëm sipas Nenit 17 pika 4, për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Bordit.

6. Në rast të tillë përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së FPBOK-së dhe organizimin e Kuvendit janë: Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm dhe punonjësit e shërbimit administrative profesional të saj.
7. Në rast të dorëheqjes së Kryetarit, Sekretari i përgjithshëm obligohet të thërras Kuvendin e Jashtëzakonshëm sipas Nenit 15 pika 4, për zgjedhjen e Kryetarit dhe Bordit të ri për pjesën e mbetur të mandatit.

Neni 24

Funksionet e Bordit

1. Bordi i Federatës, mes tjerash, kryen funksionet si në vijim:
 - 1.1. Merr vendimin për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit sipas Nenit 15 të këtij Statuti dhe propozon rendin e ditës për të.
 - 1.2. Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera që i miraton Kuvendi.
 - 1.3. Ekzekuton vendimet, konkluzionet dhe politikat e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi.
 - 1.4. Nxjerr rregullore tjera që nuk janë në kompetencë të Kuvendit të Federatës.
 - 1.5. Jep pëlqimin për planin e punës dhe planin financiar vjetor të Federatës.
 - 1.6. Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm të FPBOK-së.
 - 1.7. Emëron dhe shkarkon Komesarin e Garave.
 - 1.8. Emëron dhe shkarkon përzgjedhësit e të gjitha ekipeve kombëtare të Kosovës në boccia.
 - 1.9. Themelon trupa punuese të veta, emëron dhe shkarkon anëtarët e tyre.
 - 1.10. Bën monitorimin financiar dhe llogaridhënien financiare në baza mujore.
 - 1.11. Miraton listën e zyrtarëve të autorizuar për ndeshjet e zhvilluara nën ombrellën e FPBOK-së (gjyqtarë, vëzhgues).
 - 1.12. Propozon Kuvendit Sistemin e garave.
 - 1.13. Miraton propozicionet dhe kalendarin e garave.
 - 1.14. Shqyrton dhe miraton planprogramin e Këshillit Profesional dhe Rregulloren për Punën e ekipeve kombëtareve të FPBOK-së.
 - 1.15. Cakton lartësinë e taksës për të gjitha aktivitetet në FPBOK-së.
 - 1.16. Vendosë për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve për kryerjen e punëve të përgjithshme dhe të veçanta në FPBOK.
 - 1.17. Nxjerr Rregulloren për kompensime dhe mëditje.

Neni 25

Komisionet e Bordit

1. Bordi zgjedhë këto komisione:
 - 1.1. Komisioni disiplinor
 - 1.2. Komisioni për organizimin e garave në boccia
 - 1.3. Komesarin e Garave

2. Me qëllim të realizimit të aktiviteteve të FPBOK-së, Bordi mund të zgjedhë edhe komisione tjera përpos atyre të cekura në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Bordi Ekzekutiv mund të krijojë, shpërbëjë, bashkojë, pezullojë funksionimin dhe rregullojë në mënyra të tjera Komisionet dhe Grupet e Punës, kohë pas kohe, sipas rrethanave.
4. Numri i personave që shërbejnë si anëtarë në secilin Komision përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv para emërimit të anëtarëve të Komisionit përkatës.
5. Kryetari i secilit Komision do t'i paraqes Bordit Ekzekutiv një raport vjetor të aktiviteteve, duke tërhequr vëmendjen për çdo rekomandim që Komisioni dëshiron të bëjë. Pranimi i raportit nuk do të nënkuptojë automatikisht pranimin e rekomandimeve të tilla.

Neni 26

Kryetari i FPBOK-së

1. Kryetarin e Federatës e zgjedhë Kuvendi me mandat katër (4) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje për mandate të njëpasnjëshëm.
2. Kryetari i Federatës me automatizëm është Kryetar i Bordit dhe Kryetar i Kuvendit të Federatës.
3. Kryetari për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit të Federatës.
4. Kandidatët për Kryetar të Federatës mund të propozohet secili delegatë i kuvendit.
5. Kryetar i FPVK-së zgjidhet kandidati që ka fituar së paku një votë më shumë se gjysma e votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.
 - 5.1. Në qoftë se asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryetar në rrethin e parë nuk e merr këtë numër të votave, atëherë në rrethin e dytë të votimit delegatët e Kuvendit votojnë për dy (2) kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë numrin më të madh të votave.
 - 5.2. Pas votimit në rrethin e dytë, Kryetar zgjidhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave.
6. Kuvendi mund ta shkarkojë Kryetarin edhe para skadimit të mandatit, në qoftë se vërtetohet se ka punuar në kundërshtim me Statutin dhe aktet e tjera normative të FPBOK-së.
 - 6.1. Për shkarkimin e Kryetarit duhet të votojnë 50%+1 e delegatëve të kuvendit.
 - 6.2. Pas shkarkimit të Kryetarit, Kuvendi zgjedh Kryetarin e ri sipas procedurës së parashikuar me këtë Statut, në mbledhjen e Kuvendit e cila duhet të thirret sipas Nenit 17.
 - 6.3. Pas shkarkimit të Kryetarit, Sekretari i përgjithshëm duhet ta thërret Kuvendin zgjedhor brenda 30 ditëve nga dita e shkarkimit.
 - 6.4. Në rast të shkarkimit të Kryetarit të FPBOK-së, me punët e FPBOK-së udhëheq Sekretari i përgjithshëm deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

Neni 27

Detyrat e Kryetarit të FPBOK-së

1. Kryetari ka përgjegjësi dhe kryen këto detyra:
 - 1.1. Përfaqëson FPBOK-në në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj.
 - 1.2. Thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të FPBOK-së;
 - 1.3. Thërret dhe kryeson mbledhjet e Bordit, dhe udhëheq punën e tij.

- 1.4. Siguron realizimin e programeve, planeve dhe konkluzioneve të Kuvendit, Bordit dhe organeve tjera të FPBOK-së.
- 1.5. Siguron ligjshmërinë e veprimtarisë së FPBOK-së.
- 1.6. Është përgjegjës për kontrollimin e realizimit të planit financiar.
- 1.7. Nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi dhe Bordi.
- 1.8. Mbikëqyrë përgatitjen e materialeve të nevojshme për mbledhjet dhe punën e Kuvendit, Bordit dhe organeve tjera të FPBOK-së.
- 1.9. Zbaton dhe udhëheqë politikat e FPBOK-së.
2. Kryetari kryen edhe punë tjera që rrjedhin nga ky Statut, vendimet e Kuvendit apo legjislatiioni përkatës në fuqi.

Neni 28

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretarin e Përgjithshëm të FPBOK-së e emron Bordi për një mandat katër (4) vjeçar me mundësi të ri-zgjedhjes pa kufizim të mandateve.
2. Sekretari i Përgjithshëm themelon marrëdhënie pune me FPBOK-në me afat të caktuar prej katër (4) vitesh, në bazë të ligjit të punës dhe akteve tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
 - 2.1. Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm duhet ti plotësoj këto kritere:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
 - Të ketë njohuri për sportin e boccia dhe menaxhmentin sportiv;
 - Të ketë njohuri të shkëlqyeshme në punën me aplikacionet e MS Office dhe komunikim elektronik;
 - Të jetë i gatshëm për të punuar jashtë orarit të punës dhe në presion të kohës.
3. Sekretari i Përgjithshëm i FPBOK-së mund të shkarkohet nga Bordi edhe para skadimit të mandatit në rast se Bordi konstaton se i njëjti ka kryer shkelje të këtij Statuti apo akteve tjera normative të FPBOK-së dhe ligjeve në fuqi.

Neni 29

Detyrat e Sekretarit të përgjithshëm të FPBOK-së

1. Sekretari i Përgjithshëm, ka këto përgjegjësi:
 - 1.1. Sigurimin e ligjshmërisë së punës dhe kryerja e obligimeve të përcaktuara ligjore, administrative, financiare dhe organizative të FPBOK-së në mënyrë profesionale dhe sipas parimeve të kodit etik, duke përfshirë por duke mos u limituar edhe në funksionet si në vijim:
 - 1.2. Përgatitjen me kohë të materialeve për mbledhjet e Kuvendit dhe mbledhjet e Bordit Ekzekutiv;
 - 1.3. Ndhmon në mbarëvajtjen e të gjitha mbledhjeve të organeve dhe komisioneve të FPBOK-së në cilësinë e këshillëdhënësit apo anëtarit;
 - 1.4. Përgatit materialet, dokumentet dhe raportet e duhura për aplikim në procesin e kategorizimit;

- 1.5. Përgatit materialet, dokumentet dhe raportet e duhura për dorëzim ose aplikim në Departamentin të Sportit në Ministrinë përkatëse për sport me qëllim të raportimit dhe mbylljes së kisteve kuartale si dhe të marrëveshje sponsorizuese
- 1.6. Përkujdeset për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv;
- 1.7. Ekzekutimin dhe monitorimin e planit financiar të FPBOK-së në bazë të kërkesave dhe vendimeve të Bordit Ekzekutiv;
- 1.8. Zbatimin e plan-programit ditor dhe planit strategjik të FPBOK-së;
- 1.9. Komunikimin dhe bashkëpunimin me Ministrinë përkatëse për sport, KPK, federatat tjera sportive dhe organizatat tjera ndërkombëtare sportive;
- 1.10. Sigurimin e transparencës dhe punës publike të FPBOK-së;
- 1.11. Monitoron publikimet e FPBOK-së në web-faqe, rrjetet sociale dhe media.

Neni 30 **Këshilli mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës është organ mbikëqyrës i FPBOK-ës, i cili përbëhet nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi i FPBOK-së me mandat katër (4) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të organeve dhe trupave punuese tjera të FPBOK-së.
3. Çdo anëtar apo organ i FPBOK-së duhet të bashkëpunoj me Këshillin Mbikëqyrës.
4. Këshilli mbikëqyrës e përcjell ligjshmërinë e punës së Bordit dhe anëtarëve të FPBOK-së si dhe mbikëqyr realizimin e planit financiar të FPBOK-ës.
5. Këshilli Mbikëqyrës i raporton për punën e vetë Kuvendit të FPBOK-së.
6. Metoda dhe modalitetet e punës së Këshillit Mbikëqyrës përcaktohen me Rregulloren e Punës së Këshillit Mbikëqyrës të cilin e miraton Kuvendi i FPBOK-së.

Neni 31 **Shoqatat e FPBOK-së**

1. Në FPBOK mund të themelohen shoqata të cilat janë të pavarura në kryerjen e veprimtarisë së tyre nëpërmjet organeve drejtuese të zgjedhura në përputhje me aktet e tyre normative.
 - 1.1. Shoqata e Sportistëve (Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-277)
 - 1.2. Shoqatat bashkëpunojnë dhe i rekomandojnë FPBOK-së për edukimin dhe rekrutimin e eksperteve të lëmisë përkatëse, në harmoni me qëllimet e FPBOK-së.
 - 1.3. FPBOK ka në përgjegjësi që të edukoj dhe avancoj këta ekspert lidhur me aktivitetet e tyre në territorin e Kosovës.
2. Shoqatat nuk mund të gëzojnë të drejtat dhe statusin e anëtarëve të FPBOK-së.

Neni 32 **Financimi i FPBOK-së**

1. FPBOK posedon mjetet e veta financiare dhe pasurinë e saj me të cilat disponon në mënyrë të papenguar.

- 1.1. Përgjegjës për mbarëvajtjen financiare të FPBOK-së janë Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i FPBOK-së, të cilët gëzojnë nivele të ndryshme të autorizimeve për realizimin e pagesave për nevoja të Federatës.
- 1.2. Nivelet përkatëse të autorizimit do të përcaktohen me Rregulloren e Brendshme të FPBOK-së.
2. Burimet financiare të FPBOK-së janë:
 - 2.1. Pagesat nga anëtarësia e FPBOK-së.
 - 2.2. Pagesat e kuotizimit të anëtarëve.
 - 2.3. Të hyrat nga organizimi i garave vendore dhe ndërkombëtare.
 - 2.4. Donacionet dhe grantet nga autoritetet publike dhe subjektet private;
 - 2.5. Të hyrat nga të drejtat e transmetimeve.
 - 2.6. Të gjitha burimet tjera të financimit të lejuara me ligj.
3. FPBOK është pronare e vetme e të drejtave të transmetimit të garave të organizuara nën ombrellën e FPBOK-së.
 - 3.1. FPBOK ka të drejtën e menaxhimit, shitjes në mënyrë vetanake ose në partneritet me ndonjë biznes tjetër, të këtyre të drejtave, me qëllim që mjetet e grumbulluara do të shpërndahen në mes të FPBOK dhe klubeve sipas rregullores përkatëse.
 - 3.2. Të drejtat e transmetimeve nga të gjithë anëtarët e FPBOK-së duhet që të përcaktohen me Kontratë pas pëlqimit nga FPBOK.
4. Realizimi i të hyrave dhe shpenzimeve kryhet sipas planit financiar të miratuar paraprakisht nga Kuvendi i Federatës.

Neni 33

Garat e FPBOK-së

1. Gara zyrtare në sportin e boccia në Republikën e Kosovës mund të organizohen vetëm nga FPBOK.
2. Garat zhvillohen në bazë të Rregullave zyrtare të BISFED dhe FPBOK-së.
 - 2.1. Në udhëheqjen e garave, organi përkatës i garave duhet t'i respektojë të gjitha vendimet e BISFED dhe FPBOK-së.
 - 2.2. Garat në boccia organizohen nga Komisioni i garave në koordinim me Komesari i garave..

Neni 34

Përfaqësueset e Kosovës

1. Me qëllim të përparimit dhe realizimit të arritjeve të rezultateve të larta në Boccia si në arenën vendore apo ndërkombëtare, FPBOK-ja formon përfaqësueset e Kosovës në Boccia (ne tekstin e mëtejme: Përfaqësueset) për të gjitha kategoritë.
2. Paraqitja për përfaqësueset e Kosovës është obligim dhe nderë për çdo anëtar të saj.
3. Udhëheqja e ekipit përfaqësues të Kosovës është në kompetencë e Përzgjedhësit të Kosovës.
4. Në punën profesionale me ekipet përfaqësuese angazhohen edhe trajnerët që emërohen nga Bordi Ekzekutiv.

5. Me rregulloren e punës së ekipeve përfaqësuese të Kosovës, përcaktohet mënyra e veprimtarisë, të drejtat dhe obligimet, kushtet e punës së përzgjedhësit, trajnerëve dhe anëtarëve tjerë të përfaqësueses.

Neni 35

Shërbimi Administrativo-profesional

1. Të punësuarit në FPBOK, të drejtat dhe obligimet e tyre nga marrëdhënia e punës i realizojnë në bazë të Ligjit përkatës në fuqi mbi marrëdhënien e punës.
2. Mjetet e ndara për pagesën e punonjësve administrativo-profesional të FPBOK-së përcaktohen në planin financiar të FPBOK-së.

Neni 36

Rregulloret e FPBOK-së

1. Rregullorja e Brendshme, Sistemi i Garave si dhe Propozicionet e Garave nuk mund të ndryshohen dhe plotësohen gjatë edicionit garues i cili është në rrjedhë e sipër.

Neni 37

Juridiksioni i FPBOK-së

1. FPBOK-ja ka juridiksion në të gjitha çështjet që ndërlidhen me boccia në Republikën e Kosovës dhe që i takojnë asaj.
 - 1.1. Për çdo mosmarrëveshje në mes anëtarëve të FPBOK-së, në mes FPBOK-së dhe anëtarëve të saj qofshin ata sportist, trajnerë, klube, menaxherë, mjek, sponsorë etj, mund të përdoren mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike pranë komisioneve përkatëse të FPBOK-së.
 - 1.2. Vetëm kur të janë shterur të gjitha mjetet juridike të FPBOK-së, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Ministrisë së Sportit e pastaj edhe Këshillit të Arbitrazhit Sportiv KAS në KPK.
2. Për kontestet ndërkombëtare juridiksioni i takon BISFED varësisht prej çështjes së kontestit.
3. Pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike qoftë në kontestet vendore apo ato ndërkombëtare, kompetente është Gjykata e Arbitrazhit Sportiv CAS në Lozan.
4. FPBOK-ja siguron që ajo dhe anëtarët e saj do ti respektojnë vendimet e marra nga trupat e Ministrisë përkatëse për sport, KAS, WPV, BISEFED dhe CAS.

Neni 38

Pushimi i veprimtarisë së FPBOK-së

1. FPBOK pushon punën e saj kur për këtë deklarohen 2/3 e anëtarëve të pranishëm të FPBOK-së ose sipas Ligjeve dhe akteve nënligjore të Republikës së Kosovës.
 - 1.1. Sipas ligjeve në fuqi mund të pushoj veprimtaria edhe nëse mbetet më me pak se pesë (5) anëtar në tri (3) regjione të ndryshme.
2. Në rast të pushimit të veprimtarisë së FPBOK-ës, atëherë e tërë pasuria e saj i kalon në ruajtje Departamentit të sportit deri sa të themelohet organizata e cila i merr përsipër të drejtat dhe detyrat e FPBOK-së dhe destinohen për sportin e boccia.

Neni 39
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. FPBOK-ja brenda afatit prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, duhet që ti aprovoj aktet e saj të brendshme që rrjedhin nga ky Statut. Aktet të cilat janë në fuqi, do të vlejnjë deri në nxjerrjen e akteve të reja.
2. Të gjithë anëtarët e FPBOK-së janë të obliguar t'i miratojnë dhe harmonizojnë aktet normative përkatëse me këtë Statut në afatin prej më së largu gjashtë (6) muaj nga dita e aprovimit të këtij Statuti.
3. Të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara në këtë statut dhe ato që paraqiten si rezultat i fuqisë madhore, do ti zgjedh Bordi i FPBOK-se me vendim i cili duhet të jetë në harmoni me interesin më të mirë për sportin e boccia, etiken dhe të drejtën. Për këto vendime të Bordit, nuk mund të paraqitet ankesa.

Neni 40
Interpretimi i Statutit të FPBOK-së

1. Interpretimin zyrtar të këtij Statuti e bënë Kuvendi i FPBOK-së i cili mund të kërkoj këshilla nga Bordi Ekzekutiv dhe organet e saj profesionale.

Neni 41
Hyrja në fuqi

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i FPBOK-së.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet statuti paraprak.

Kryetari i FPBOK-së
Murat Murati



03.05.2025

